



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 53
Prishtinë, më 15 mars 2012

PROCESVERBAL

**IMBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 15 MARS 2012**

Mbledhjen e kryesoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryesuesi deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë.

Kuvendi i filloi punimet me këtë

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komunikimet elektronike,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deminimin humanitar,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë,
9. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Kimete Bytyqi, Glauk Konjufca, Teuta Haxhiu, Fikrim Damka, Ganimete Musliu, Vjosa Osmani, Shaip Muja, Liburn Aliu, Kimete Bajraktari, ndërsa në emër të Qeverisë së Kosovës, kryeministri Hashim Thaqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Teuta Haxhiu, parashtoi pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me vendimin për futjen e gjuhës shqipe në të gjitha njësitë akademike dhe studimin paraprak të kësaj çështje. Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Teuta Haxhiu

Deputetja Time Kadrijaj, kishte parashtruar pyetje për ministrin Ramë Buja, në lidhje me shpalljen e konkursit për studime të doktoratës, mirëpo në ndërkohë është shpallur konkursi. Me këtë rast deputetja uroi që procesi të zhvillohet sipas rregullave të konkursit.

Deputetja Alma Lama, parashtoi pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri, në lidhje me atë se në dialogun me Serbinë nuk e keni futur në agjendë kthimin e personave të pagjetur nga lufta në Kosovë.

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, iu përgjigj pyetjes së deputetes Alma Lama

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi parashtoi pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri, në lidhje me atë se sa kushtoi periudha e pas fusnotës?

Zëvendëskryeministrja Edita Tahiri, iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kadaj-Bujupi

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, parashtoi pyetje për zëvendëskryeministren Mimoza Kusari-Lila, në lidhje me zbatimin e masave të reciprocitetit me Serbinë.

Zëvendëskryeministrja Mimoza Kusari-Lila, nuk ishte prezente në sallë.

Deputetja Aurora Bakalli, parashtoi pyetje për ministrin Enver Hoxhaj, në lidhje me atë, se siç tha ajo, në paraqitjet e ministrit Hoxhaj në OKB, po e heshtni spastrimin etnik të shqiptarëve të Mitrovicës.

Ministri Enver Hoxhaj, iu përgjigj pyetjes së deputetes Aurora Bakalli.

Deputetja Kimete Bytyqi, parashtoi pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi në lidhje me numrin e të punësuarve të gjinisë femërore dhe arritjen e kriterit të barazisë gjinore në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, iu përgjigj pyetjes së deputetes Kimete Bytyqi.

Pastaj, për fjalë u paraqit deputeti Adem Grabovci.

Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, propozoi që Kuvendi ta radhitë si pikë të rendit të ditës të mbledhjes së sotme plenare, miratimin e një rezolute për kundërshtimin e mbajtjeve të zgjedhjeve serbe në Republikën e Kosovës.

Ai shtoi se për këtë çështje janë pajtuar edhe grupet e tjera parlamentare.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e cekur më lart.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	75,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, njëzëri vendosi që në rend dite, si pikë e 4-të, të radhitet-miratimi i Rezolutës kundër mbajtës së zgjedhjeve serbe në Republikën e Kosovës.

3. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve plenare të mbajtura më 1 - 2 dhe 9 mars 2012

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, pati vërejtje në procesverbalin e 9 marsit, në formulimin: “Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë edhe këta deputetë”. Kur të ketë debat parlamentar të thuhet: “Në debat morën pjesë edhe këta deputetë” dhe të jepen emrat e deputetëve.

Kuvendi, me vërejtjen e nënkryetarit Sabri Hamiti, miratoi procesverbalet e mbledhjeve plenare, të mbajtura më 1, 2 dhe më 9 mars 2012.

4. Miratimi i Rezolutës kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Republikën e Kosovës.

Kryesuesi ftoi propozuesin që ta paraqesë dhe arsyetojë këtë pikë.

Adem Grabovci tha se pas vendimit të Qeverisë së Serbisë, për mbajtjen e zgjedhjeve në Kosovë, janë takuar liderët e subjekteve politike dhe shefat e grupeve parlamentare dhe janë pajtuar që Kuvendit t’ia propozojnë nxjerrjen e një rezolutë kundër mbajtjes së zgjedhjeve të Serbisë në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim, deputeti Adem Grabovci paraqiti tekstin e Rezolutës.

Sabri Hamiti, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, tha se është më se e nevojshme që Kuvendi të marrë një qëndrim rreth mbajtjes së zgjedhjeve serbe në Republikën e Kosovës.

Ai propozoi që pika e dytë e tekstit të propozuar, të riformulohet: “Kuvendi i Kosovës nuk do të lejojë zgjedhje të Serbisë në Kosovë dhe i obligon institucionet që ta zbatojnë këtë vendim”.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, tha se grupi i tyre nuk është konsultuar lidhur me propozimin e paraqitur nga deputeti Adem Grabovci.

Ai shtoi se Qeveria e Kosovës nuk duhet të lejojë mbajtjen e zgjedhjeve të Serbisë në territorin e Republikës së Kosovës..

Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, tha se përkrahim miratimin e Rezolutës në Kuvendin e Kosovës lidhur me zgjedhjet serbe në Kosovë.

Në vazhdim deputeti Muhamet Mustafa u fokusua në riformulimin e pikave në tekstin e propozuar, ku duhet të thuhet qartë: Kosova nuk do të lejojë mbajtjen e zgjedhjeve serbe në territorin e Republikës së Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe këta deputetë: **Halit Krasniqi, Alma Lama, Vjosa Osmani** dhe **Agim Kuleta**, si dhe zëvendëskryeministri **Hajredin Kuçi**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në vazhdim, kryesuesi caktoi një pauzë deri në orën 15:30 minuta, ndërsa theksoi se takimi i përfaqësuesve të grupeve parlamentare do të mbahet në sallën 303, në orën 14:30, për ta harmonizuar tekstin e Rezolutës.

Pas pauzës, kryesuesi ftoi kryetarin e GP të PDK-së, që para deputetëve ta paraqesë tekstin e harmonizuar të Rezolutës.

Adem Grabovci tha se përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare, duke përfshirë edhe atë të lëvizjes “Vetëvendosje”, janë pajtuar me tekstin e Rezolutës, të cilin ai e paraqiti.

Kryesuesi hodhi në votim Propozim-rezolutën e paraqitur nga deputeti Adem Grabovci. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76,
Kundër-----0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje në nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Duke ritheksuar se Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik dhe shoqëri multietnike me parime evropiane,

Duke theksuar zotimin tonë në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës,

Duke riafirmuar përkushtimin e Republikës së Kosovës për të ardhmen e saj euro-atlantike dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore,

Duke ritheksuar zotimin e Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të gjithë qytetarëve të saj, duke përfshirë të drejtat e komuniteteve dhe të drejtën e dyshtetësisë, duke marrë në konsideratë që të gjithë ata që kanë dyshtetësi në vendet evropiane kanë të drejtë të

votojnë në zgjedhjet parlamentare të cilat mbahen në shtetet në të cilat ata e kanë shtetësinë përkatëse,

Në mbledhjen plenare të mbajtur më 15 mars 2012, miratoi këtë:

R e z o l u t ë

1. Theksojmë se është shkelje e sovranitetit dhe cenim i marrëdhënieve të mira fqinjësore, që të organizojë në mënyrë të njëanshme zgjedhje të përgjithshme dhe lokale në një shtet tjetër evropian;
2. Konkludojmë se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk lejon mbajtje të zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë dhe obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës të realizojë këtë vendim.
3. Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, njëzëshëm theksojnë se qytetarët e Republikës së Kosovës janë ta bashkuar kundër mbajtjes së çfarëdo procesi zgjedhor, i cili do të minonte sovranitetin shtetëror të Kosovës, do të cenonte shtetësinë e saj, do të cenonte integritetin territorial të saj dhe rrjedhimisht do të minonte procesin e pajtimit ndëretnik në Kosovë.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës konfirmon se të gjitha subjektet politike, qofshin ato në pozitë apo opozitë, do të punojnë në përputhje me parimet evropiane, me të drejtën ndërkombëtare dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion, propozoi që pika 9 - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë**, të hiqet nga rendi i ditës së sotme dhe të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Ai këtë e arsyetoi se amendamenti nr. 16 nuk ka kaluar fare në Komisionin për Legjislacion.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e deputetit Arben Gashi.

Lidhur me këtë u deklaruan: në emër të GP të lëvizjes “Vetëvendosje”, Alma Lama, ndërsa në emër të GP të AAK-së, Ardian Gjini, si dhe në emër të Qeverisë, zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, të cilët u pajtuan që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi kërkoi që Kuvendi përmes një votimi formal të deklarohet për propozimin e lartpërmendur.

Kuvendi miratoi propozimin që pika e 9-të - **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë**, të shtyhet për mbledhjen plenare të radhës.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komunikimet elektronike

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që, që para deputetëve të Kuvendit, ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për komunikimet elektronike.

Ministri **Besim Beqaj** tha se ky projektligj është plotësim-ndryshim i Ligjit për telekomunikacionin.

Në vazhdim theksoi se Projektligji parasheh rregullimin e marrëdhënieve shoqërore që kanë të bëjnë me rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike, përdorimin e burimeve të komunikimeve elektronike, si dhe marrëdhënieve shoqërore që kanë të bëjnë me radio pajisjet, dhe përputhshmërinë elektromagnetike.

Më pas ai u fokusua në aspekte tjera të këtij projektligji si dhe në strukturën e tij.

Në fund, ministri **Besim Beqaj** i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim, Projektligjin për komunikimet elektronike.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin në parim, të Projektligjit për komunikimet elektronike.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe këta deputetë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jeton Svirca, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët, Shaip Muja dhe Hashim Dëshishku, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin për komunikimet elektronike. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 77,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi në parim, Projektligjin për komunikimet elektronike.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision funksional dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deminimin humanitar

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional- raportues për Projektligjin për deminimin humanitar.

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së e arsyetoi anëtar i këtij komisioni, Anton Quni.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 76,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për deminimin humanitar.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional- raportues për Projektligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Raportin e Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së e arsyetoi anëtari i këtij komisioni, Anton Quni.

Në lidhje me amendamentin 11, diskutoi deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, si dhe deputetët: Liburn Aliu, Armend Zemaj dhe Fatmir Xhelili.
Pastaj, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, dhe 10.

Kuvendi nuk miratoi amendamentin 11.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi miratoi Ligjin për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional- raportues për Projektligjin për shërbimet e shoqërisë informatike
Ai hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41 42.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 72,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Ligjin për shërbimet e shoqërisë informatike

9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Ministri **Besim Beqaj**, në emër të Qeverisë së Kosovës, kërkoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare lidhur me propozimin e ministrit Besim Beqaj.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: në emër të GP të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të GP të lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të GP të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, si dhe deputetët: Ardian Gjini, Armend Zemaj, Arben Gashi, Teuta Sahatqija dhe Sabri Hamiti, ndërsa në emër të Qeverisë, ministri Besim Beqaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryesuesi, në mungesë të kuorumit, mbylli punimet e mbledhjes plenare, në orën 17:05 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit

Xhavit HALITI

Përgatiti:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale